



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin *Hashim Thaçi dhe të bashkakuzuarit*, këtë javë kanë dëshmuar tre dëshmitarë me masa mbrojtëse.

Sipas Prokurorisë, dëshmitari i 42-të, i cili filloi dhënien e dëshmisë të hënën, u rrëmbye dhe u ndalua nga anëtarë të UÇK-së në zonën e Prizrenit në qershor 1999.

Dhënia e dëshmisë nga dëshmitari i 43-të i Prokurorisë filloi gjithashtu të hënën. Kjo dëshmi thuhet se lidhet me vrasjen e një viktime pasi u arrestua dhe ndalua nga anëtarë të UÇK-së në zonën e Llapit.

Të martën, dëshmitari i 44-të i thirrur nga Prokuroria filloi dhënien e dëshmisë. Sipas përmbledhjes së lexuar nga Prokuroria, dëshmitari dëshmoi për atë që pa dhe mësoi gjatë vizitave të shumta në disa shtabe të UÇK-së gjatë periudhës përkatëse, përfshirë për komandantët e UÇK-së që takoi. Ky dëshmitar dëshmoi të mërkurën dhe të enjten.

Pas seancës së djeshme gjyqësore, Trupi Gjyqësor u takua me ekipin e Mbrojtjes së Hashim Thaçit për të diskutuar në lidhje me mocionin e dorëzuar nga Mbrojtësi Gregori Kihou për tërheqjen e tij si mbrojtës.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, më 26 janar Administratorja caktoi z. Laurens van Pajenbruk (Laurens van Puyenbroeck) si mbrojtës kujdestar të z. Mustafa. Caktimi i tij pasoi vendimin e Panelit të Gjykatës Supreme, i cili konstatoi se emërimi i mëhershëm i Venkatesvari Alagendrës si mbrojtëse e z. Mustafa nuk kishte efekt ligjor pasi znj. Alagendra nuk e njoftoi Trupin Gjyqësor II për synimin e saj për të përfaqësuar edhe zotin Mustafa krahas zotit Krasniqi, dhe as nuk mori vendim nga Trupi Gjyqësor nëse ekziston konflikt interesi.

Në çështjen gjyqësore *Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari*, më 29 janar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Ismet Bahtijarit. Gjykatësi konstatoi se ekziston rrezik i moderuar që i akuzuari të arratiset, si dhe arsye të artikuleshme për të besuar se z. Bahtijari mund të pengojë ecurinë e procesit gjyqësor ose të kryejë krime të tjera.

Në aktakuzën kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari, sikurse është konfirmuar, thuhet se midis së paku 5 prillit 2023 dhe 12 prillit 2023, z. Januzi dhe z. Bahtijari u takuan secili më vete me një dëshmitar për ta nxitur dëshmitarin që të tërhiqte dëshminë, ose të mos jepte dëshmi në proceset zyrtare para Dhomave të Specializuara të Kosovës, përfshirë përmes përdorimit të kërcënimit të rëndë. Të dy të akuzuarit u vetëdeklaruan të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.





Në çështjen gjyqësore kundër Haxhi Shalës, këtë javë Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi versionin e redaktuar publik të vendimin të vet të 4 dhjetorit për konfirmimin e aktakuzës kundër z. Shala. Kjo aktakuzë u bë publike më 12 dhjetor 2023. Z. Haxhi Shala akuzohet lidhur me një tentativë të pretenduar për të frikësuar një dëshmitar. Ai u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me akuzat kundër tij.

### **Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

